



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 112/2013
Prishtinë, më 02.07.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S–I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZPRK; Darsei Canhasi – INDEP; Agron Demi – GAP; Avni Tusha, Imba Rudaku, Arta Lokaj, Qëndresa Mrasori – praktikantë.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.06.2013;
3. Votimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe dhe i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike;
4. Te ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 18.06.2013

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 18.06.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Votimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe dhe i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike

Kryetari – tha se në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar dhe i kemi shqyrtuar Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe dhe Raportin me propozim amendamente për Projektligjin Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike por në mungesë të kuorumit nuk kemi mundur të marrim një vendim. Dhe i ftoj deputetët që të votojnë për këto dy raporte.

Në lidhje me Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe, pa debat deputetët miratuan njëzëri raportet si në vijim:

R e k o m a n d i m

- *Qeveria të përfshijë në Plotësim Ndryshimin e Strategjisë Legjislative për vitin 2013, plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe. Rekomandimet që plotësimi dhe ndryshimi i ligjit në veçanti të fokusohet në:*
 - mundësinë e aplikimit të masës mbrojtëse në formën e kuotës;
 - shqyrtimin e kufizimit 25% për një prodhues apo 50% për një grup prodhuesish të prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme apo identike;
 - përfshirjen e mekanizmave shtesë për kërkesat e ruajtjes së informatave konfidenciale;
 - harmonizimin e afateve kohore për masat e përkohshme mbrojtëse me Rregullat e OBT-së dhe BE-së;
- *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të veprojë në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe, duke inicuar hetim pa pasur kërkesë me shkrim nga ose në emër të prodhuesit vendor;*
- *Qeveria dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të përkrahë me veprime konkrete Departamentin e Tregtisë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative;*
- *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, duhet t'i raportojë Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për nivelin e zbatimit të ligjit së paku një herë në vit.*

Ndërsa në lidhje më Raportin më propozim amendamente për projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike po ashtu pa debat nxorën këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit Nr.04/L-198 për tregtinë e mallrave strategjike.*
- 2. Raporti t'u procedohet komisioneve të përhershme, sipas procedurës.*

4. Te ndryshme
Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti